



**RAPORTIMI I ÇËSHTJEVE TË FËMIJËVE NË MEDIAN E  
SHKRUAR:**

**MONITORIMI I GAZETAVE TË  
PËRDITSHME KRYESORE**

*(MAJ 2010)*

**Realizuar me mbështetjen e UNICEF**

# Hyrja


Për të pasur një ide sa më të mirë për mënyrën se si media pasqyron dhe paraqet fëmijët, një raport monitorues për katër gazetat kryesore u krye për muajin maj 2010. Gazetat e përditshme përfaqësonin median kryesore dhe u përzgjedhën ato që mendohen se kanë edhe numrin më të madh të kopjeve të shitura. Meqë nuk ekzistojnë të dhëna zyrtare për shitjet e gazetave dhe tirazhin e tyre në përgjithësi, përzgjedhja e gazetave për monitorim u krye sipas konsultimeve me kryeredaktorët e të përditshmeve. Botimet e përditshme të përfshira në raportin monitorues ishin: *Shekulli*, *Panorama*, *Gazeta Shqiptare*, *Shqip*.

Gjatë kësaj kohe u monitoruan të gjithë artikujt që kishin të bënin me ose përfshinin apo preknin fëmijët. Fëmijët në këtë rast u përkufizuan si personat nën 18 vjeç. Për të pasur një pamje sa më të plotë që të jetë e mundur, artikujt që nuk përqendroheshin posaçërisht te fëmijët, por kishin të bënin me ta, u morën gjithashtu parasysh.


## 1. Analiza sasiore

Analiza e artikujve të monitoruar ishte si sasiore, ashtu edhe cilësore. Numri i përgjithshëm i artikujve të monitoruar ishte 157 artikuj për të katër gazetat. Artikujt e monitoruar nuk përfshinin vetëm lajmet, por edhe editorialet, reportazhet, lajmet e shkurtra, etj. Gjatësia e artikujve varionte nga dy paragrafë në një faqe të tërë gazete, në varësi të lajmit që paraqiste.

Grafiku i mëposhtëm paraqet pasqyrimin e të miturve sipas secilës gazete, për të gjithë periudhën e monitorimit:



Grafiku i mëposhtëm pasqyron numrin e artikujve sipas ndarjes së temave:



Si mund të shihet nga ndarja e artikujve sipas temave që trajtojnë, ndryshe nga monitorime të mëparshme, ku kronika e zezë mbetej tema mbizotëruese përse i përket pasqyrimin të të miturve nga shtypi i përditshëm, ky muaj paraqet një risi. Në pasqyrimin total, ajo zë vetëm 13% të të gjithë hapësirës. Ndërkohë, tema të tilla si arsimit dhe shëndetësia, duket se kanë marrë më tepër përparësi, me përkatësisht 40% dhe 27%. Për të parë më nga afër veoritë e pasqyrimin të këtyre temave, analiza e mëposhtme do të jetë e dobishme.

## 2. Analiza cilësore

Përgjithësisht gazetave vazhdojnë të jenë të qëndrueshme në lidhje me temat për fëmijët që ato pasqyrojnë. Përveç larmisë së temave të pasqyruara dhe informacionit të sjellë, analiza përqendrohet edhe në sjelljen etike të gazetave me fëmijët, në interesin publik përballë mbrojtjes së privatësisë, në përdorimin e burimeve për pasqyrimin e fëmijëve, në sensacionalizmin përballë gazetarisë së komunitetit, etj. Sektorët që pasojnë identifikojnë problemet që mbizotërojnë, temat, si dhe rastet që kanë të bëjnë me pasqyrimin e fëmijëve në gazeta. Duke e ilustruar analizën me artikujt për ngjarjet dhe rastet më domethënëse që kanë të bëjnë me të miturit, kjo analizë do të përpiqet të hedhë dritë për problemet dhe përmirësimet kryesore që ka bërë media shqiptare në lidhje me pasqyrimin e fëmijëve.

### **Identifikimi i të miturve**

Një nga aspektet më të ndjeshme të monitorimit të pasqyrimin të fëmijëve studimi i mënyrës se si ata identifikohen, paraqiten dhe trajtohen, sidomos në kohë telashesh dhe rastesh që kanë të bëjnë me kronikën e zezë. Natyrisht që këto janë raste delikate edhe për të rriturit; megjithatë, nga pikëpamja etike ato marrin një rëndësi të veçantë kur bëhet

fjalë për fëmijët, duke pasur parasysh kujdesin dhe metodat e veçanta që duhen përdorur për fëmijët. Krahasuar me disa vite më parë, kur identifikimi dhe pasqyrimi i të miturve ishte një problem madhor në median shqiptare, ka pasur përmirësime të ndjeshme në këtë fushë. Gjithashtu, vlen të përmendet se ky aspekt ka patur përmirësim edhe krahasuar me monitorimin me të njëjtat parametra që është bërë një vit më parë.

Më në veçanti, tipari kryesor me të cilin mund të fillojë kjo analizë është identifikimi i të miturve në media. Edhe pse në dukje i thjeshtë, në praktikë ekzistojnë mënyra të ndryshme të zgjidhjes së këtij problemi dhe fatkeqësisht, ka ende disa prej tyre që nuk kanë parasysh interesin më të mirë të fëmijës. Megjithatë, duhet përmendur se mënyra më e zakonshme për të identifikuar të miturit në këto gazeta është me anë të moshës dhe inicialeve. Përrjashtim në këtë rast bëjnë vetëm ato artikuj kur të miturit janë në aspekte pozitive (kryesisht për portrete) dhe ato raste kur të miturit kanë probleme të ndryshme, por është e qartë nga konteksti i artikullit që prindi jo vetëm ka dhënë lejen për identifikimin dhe intervistimin e fëmijës, por është dhe vetë pjesmarrës në artikull.

Më konkretisht, gjatë këtij muaji në gazetë ka pasur disa artikuj që mund të kategorizohen si kronikë e zezë, ku ishin të përfshirë të mitur. Pothuajse në çdo rast, ata kanë qenë të identifikuar me iniciale dhe moshë, ose vetëm me moshë, me përjashtim të rasteve kur ka pasur të mitur të konsideruar të humbur, ku identifikimi ka qenë i plotë dhe me fotografi.

Për shembull, një nga rastet më të rënda ka qenë ai i një babai që dyshohej se kishte marrëdhënie incestuale me dy vajzat e tij të mitura, një shqiptar që jetonte në Greqi. Njëra nga gazetatat nuk ka dhënë as identitetin e babait dhe as të vajzave, me përjashtim të moshës,<sup>1</sup> ndërsa gazeta tjetër jepte gjithashtu moshat e vajzave, por edhe babai identifikohet si Fatos G., duke e bërë të qartë që mund të mos ishte identiteti i tij i vërtetë, sipas policisë.<sup>2</sup> Pra, në asnjë nga rastet nuk është rrezikuar që të identifikohen të miturat, gjë që do ta kishte shpënë dramën dhe vuajtjen e tyre në një nivel akoma më të vështirë për t'u përballuar.

E njëjta qasje është përdorur edhe në raste të tjera ku janë përfshirë të mitur. Kështu, në rastin e një të miture të përdorur për prostitucion, ajo identifikohet si “17-vjeçarja B.Q.”<sup>3</sup> Ndërkohë, në një rast tjetër, ku një 14-vjeçare akuzonte tre persona për përdhunim, ajo identifikohet vetëm me moshë dhe artikulli i referohet si “e mitura.”<sup>4</sup> Pra, si mund të shihet, në raportimin e kronikës së zezë gazetatat kanë arritur të kenë një praktikë pak a shumë të konsoliduar për një tipar elementar, por edhe tejet të rëndësishëm si është identifikimi i të miturve.

---

<sup>1</sup> “Pranga shqiptarit 50-vjecar në Greqi, përdhunonte të bijat,” *Gazeta Shqiptare*, 30/05/2010, f.8.

<sup>2</sup> “Babai monstër përdhunonte të bijat,” *Shqip*, 30/05/2010, f. 21.

<sup>3</sup> “Shfrytëzoi 17-vjeçaren prostitutë, kapet tutorja,” *Panorama*, 19/05/2010, f.12.

<sup>4</sup> Gerti Xhaja, “Tre të rinj përdhunojnë 14-vjeçaren,” *Gazeta Shqiptare*, 28/05/2010, f. 10.

## **Pasqyrimi i arsimit, një shqetësim i vazhdueshëm**

Një nga temat më të pasqyruara, madje në vazhdimësi ndër vite, ka qenë ajo e arsimit, problemet me infrastrukturën e tij, si dhe aspekte të tjera. Shumica e artikujve për këtë temë është e lidhur me mungesën e kushteve të përshtatshme në shkolla dhe kopshte, infrastruktura e keqe, problemet mes mësuesve dhe nxënësve, çështje të lidhura me kurrikulën dhe sistemin arsimor në përgjithësi, reformat përkatëse, etj. Kështu, një prej artikujve ngre problemin e këshillimit të karrierës që në klasë të nëntë,<sup>5</sup> mbylljen e një shkolle dhe kthimin e nxënësve në barinj dhish,<sup>6</sup> apo shtatë vajza që përditë bënin 40 km me motoçikletë për të vajtur në shkollë,<sup>7</sup> mungesën e psikologëve në shkollat nëntëvjeçare, sidomos në rrethe,<sup>8</sup> gjendjen e papërshtatshme të disa shkollave,<sup>9</sup> e deri në tema më të lehta, si tradita e mbylljes së vitit shkollor nga maturanët.<sup>10</sup>

Pra, mund të thuhet se edhe pse periudha e monitorimit ka të bëjë me mbylljen e vitit shkollor, kjo është një temë që mbulohet pothuajse rregullisht në aspekte të ndryshme nga gazetaret shqiptarë, e jo vetëm në ditët e para të shkollës, kur është dhe ngjarja e ditës. Gjithashtu, kur flitet për mbulimin e arsimit, duhet përmendur se pasqyrimi i problemeve, sidomos me infrastrukturën, ka ardhur duke u përmirësuar dhe duke mbuluar një zonë gjeografike gjithnjë e më të gjerë.

## **Fëmijët dhe shëndeti**

Një temë që dalngadalë ka zënë një vend gjithnjë e më të rëndësishëm në gazetaret përditshme është ai i shëndetit të fëmijëve. Kjo temë përgjithësisht është trajtuar në dy mënyra: nga ana e mungesës së infrastrukturës së spitaleve dhe mungesave të tjera të shërbimit shëndetësor në vend, por edhe në ngritjen e problemeve që kanë të bëjnë me ushqimin dhe me mënyrën e rritjes së fëmijëve në përgjithësi. Kështu, shfaqen artikujt me probleme të reja që janë shfaqur edhe në shoqërinë shqiptare, si kequshqyerja e fëmijëve, sëmundjet që i prekin më shumë, prirjet kryesore të zhvillimit të fëmijëve, etj.

Artikujt e monitoruar në përgjithësi evidentojnë me shifra problemet që hasen dhe gjendjen në vend, sidomos prirjet kryesore të zhvillimit shëndetësor të miturit. Kështu, në gazetaret e monitoruara gjenden artikujt të ndryshëm, të nisur nga botimet e studimeve për aspekte të caktuara të shëndetit të fëmijët, apo deklarata të ndryshme të bëra nga institucionet kompetente në këtë fushë. Disa nga artikujt që mund të përmenden përfshijnë: „Studimi, adoleshentët tymosin për të rënë në peshë,<sup>11</sup> „Pediatria, 400 fëmijë në urgjencë me viroza stine,<sup>12</sup> „17% e fëmijëve vuajnë nga anemia,<sup>13</sup> „Fëmijët nën 5

<sup>5</sup> „Këshillimi i karrierës, që në klasë të nëntë,” *Gazeta Shqiptare*, 02/05/2010, f. 10.

<sup>6</sup> „Mirditë, mbyllet shkolla. Nxënësit shkojnë me dhi,” *Shqip*, 06/09/2010, f. 25.

<sup>7</sup> „Aventura e shtatë vajzave për të vazhduar shkollën e mesme,” *Shqip*, 10/05/2010, f. 25.

<sup>8</sup> „Shkollat nëntëvjeçare nuk kanë psikologë,” *Shqip*, 26/05/2010, f. 23.

<sup>9</sup> H. Likdisha, „Klos, 40 nxënës mësim në lagështirë,” *Shqip*, 26/05/2010, f. 24.

<sup>10</sup> Lorina Mixha, „Tradita, miell dh evezë për ‘inat’ të shkollës,” *Shqip*, 22/05/2010, f. 24.

<sup>11</sup> *Shpresa Mezini*, *Shqip*, 21/05/2010, f. 24.

<sup>12</sup> *Panorama*, 10/05/2010, f. 6.

<sup>13</sup> *Shqip*, 12/05/2010, f. 25.

vjeç, 28% më të shkurtër se mesatarja,<sup>14</sup> „Fëmijët e pavaksinuar, ISHP evidenton 168 raste në Tiranë,<sup>15</sup> „Ushqimi i keq, fëmijët me probleme,<sup>16</sup> „Të rinjtë, seks që në klasë të shtatë,<sup>17</sup> „Talasemia, fëmijët 12-13 vjeç të depistohen,<sup>18</sup> etj.

Pra, si mund të vërehet nga titujt, problematika e çështjeve shëndetësore të paraqitura në lidhje me të miturit është e gjerë, që nga sëmundjet infektive e deri te prirjet dhe mënyra e jetesës së adoleshentëve. Gjithashtu, një pjesë e artikujve bënte fjalë edhe për probleme apo prirje në këtë fushë të fëmijët e komunitetit rom, një minoritet që nuk gjen vend shpesh në media.

## **Gazetaria komunitare**

Disa nga artikujt që përqendrohen te të miturit, ndërkohë që përshkruajnë problemet e fëmijëve, janë shkruar në një mënyrë që tregon dhe përfshirjen e gazetarit në kauzën e përmirësimit të gjendjes së fëmijëve. Në disa artikuj kjo prirje është më e qartë se në të tjera. Ky monitorim ka identifikuar një numër në rritje të artikujve ku gazetarët kanë prirjen t'i ndihmojnë fëmijët për probleme të ndryshme me anë të artikujve të tyre. Këto probleme zakonisht kanë të bëjnë me fëmijë të prekur nga sëmundje të vështira, të cilët jetojnë në varfëri dhe nuk kanë mundësi shërimi, ose për fëmijë të varfër, zakonisht jetimë, të cilët bëjnë thirrje për ndihmë nëpërmjet këtyre artikujve.

Një shembull është ai i dy fëmijëve, të cilët, të braktisur nga e ëma, jetojnë në varfëri me të atin dhe kanë mbetur dhe të pastrehë pas shembjes së shtëpisë nga shirat. Artikulli është një thirrje për ndihmë për babain e fëmijëve, i cili pohon se ai së bashku me fëmijët dalin e lypin për të mbijetuar. Jo rrallë këto artikuj, për shkak edhe të qëllimit që kanë, përdorin nota sentimentaliste dhe përfshijnë detaje prekëse, si më psotë: „Më dhemb në shpirt tek e kalojmë natën jashtë, në qiell të hapur, apo kur fëmijët kërkojnë të mbushin barkun me bukë... Hallin tim e di i madh e i vogël.<sup>19</sup>

Një shembull tjetër, i trajtuar në dy gazeta, vjen nga një fshat i Korçës, ku tre fëmijët e një personi që vrau tre djem disa muaj më parë kanë lënë shkollën e janë ngujuar në shtëpinë e gjyshërve për frikë të ndonjë hakmarrjeje të mundshme. Thirrja për ndihmë është e qartë që në titullin e nënartikullit: „Apeli i Eglantinës: Shpëtoni fëmijët e mi!<sup>20</sup> një prej artikujve citon edhe vajzën e madhe: „Kam tre muaj që nuk shkoj në shkollë se kam frikë. Qëndroj e mbyllur në shëpi dhe luaj me vëllain e motrën, por nuk dal dot jashtë me shokët e shoqe, thotë e përplotur 12-vjecarja.<sup>21</sup>

---

<sup>14</sup> Panorama, 12/05/2010, f. 6.

<sup>15</sup> Gazeta Shqiptare, 11/05/2010, f. 10.

<sup>16</sup> Gazeta Shqiptare, 12/05/2010, f.13.

<sup>17</sup> Gazeta Shqiptare, 31/05/2010, f. 9.

<sup>18</sup> Lorina Mixha, Shqip, 09/05/2010, f. 24.

<sup>19</sup> Er. Az, „I braktis e ëma, dy vëllezër lënë shkollën e lypin për bukën e gojës,” Gazeta Shqiptare, 04/05/2010, f.14.

<sup>20</sup> Shqip, 11/05/2010, f. 22.

<sup>21</sup> Gezim Ashimi, „Ngujohen tre fëmijët e besim Karajt, frikë nga hakmarrja,” Panorama, 11/05/2010, f.11.

Keta artikuj janë shembuj të qartë të gazetarëve që përdorin fuqinë e medias për të ndihmuar në një lloj mënyre njerëziteti në nevojë, duke ngritur ndërgjegjësimin për problemet e tyre. Megjithatë, ekuilibri midis ruajtjes së dinjitetit të personave dhe ndihmesës së dhënë ndaj tyre është gjithnjë delikat dhe i vështirë për t'u arritur.

Ngjan se jetimet dhe fëmijët e braktisur janë tema shumë të ndjeshme për gazetarët dhe gazetatat, sepse ato janë ndër temat më të pasqyruara. Megjithatë, rrallë ndodh që të ketë një përpjekje të përbashkët dhe të organizuar për të pasqyruar këto tema si një fenomen, me të gjitha të dhënat dhe mendimet që mund të mblidhen, me rastet e veçanta për të përshkruar fenomenin, si dhe me kërkimin e zgjidhjeve të mundshme. Në fakt, siç ndodh me shumë tema të tjera, vetëm rastet më të ndjeshme paraqiten, të cilat rrallë pasohen më tej me ndjekje të fenomenit, shkaqet e tij, ndikimin dhe zgjidhjen e tij. Megjithatë, ka një ndjeshmëri në rritje të gazetave shqiptare në këtë drejtim.

### **Të miturit dhe trajtimi i fenomeneve**

Edhe pse në përgjithësi pasqyrimi i të miturve në shtypin shqiptar mbetet ende në kufirin e lajmeve dhe ngjarjeve të përditshme dhe rrallë shtrihet te fenomeni, kjo prirje dalngadalë ka nisur të ndryshojë. Nga ky monitorim, është vërejtur se gjithnjë e më shumë po shfaqen artikuj që përpiqen të shkojnë përtej ngjarjeve apo personave të momentit dhe t'i përdorin ata si spunto për të pasqyruar apo analizuar edhe fenomenin dhe ndikimin që ai ka te shoqëria.

Temat janë nga më të ndryshmet, duke nisur nga problemet e fëmijëve të komunitetit rom, fëmijët e rrugës, abuzimi me fëmijët në shkollë ose në familje, fëmijët dhe media, fëmijët dhe sistemi i mbrojtjes apo i ndihmës ndaj tyre e deri te analfabetizmi i fëmijëve. Vëmendje e posaçme u është kushtuar adoleshentëve dhe aspekteve më të vështira dhe problematike të jetës së tyre, të tilla si adoleshentët dhe duhani adoleshentët dhe seksi, etj.

Mënyra se si këto fenomene janë trajtuar nëpër gazeta është e ndryshme, në varësi të mjeteve, të dhënave, apo zërave që janë përdorur për të ilustruar problemin. Mënyrat variojnë në marrjen e mendimit të ekspertëve, në marrjen e opinioneve nga vetë të miturit, në përdorimin e shifrave zyrtare, apo të dhëna nga studime dhe nga sondazhe, këshilla nga psikologu, etj. Për shembull, njëri nga artikujt i kushton vëmendje marrëdhënies së adoleshentëve me seksin<sup>22</sup>, duke përfshirë të dhëna nga sondazhet dhe studimet e fundit:

*“Nga studimi rezulton se ekziston një lidhje e dukshme midis arsimit të prindërve, nivelit ekonomik dhe venbanimit urban me nivelin e njohurive të nxënësve mbi IST-të. Moshë e marrëdhënies së parë seksuale po spostohet mjaft drejt moshave më të vogla, ku 23% janë të moshës 14 vjeç; 27% të moshës 15 vjeç, 23% kanë pasur për herë të parë marrëdhënie seksuale kur ishin 16 vjeç, 22.5 kur ishin 17 vjeç dhe vetëm 5% kanë bërë seks për herë të parë në moshën 18-vjeçare.”*

---

<sup>22</sup> Esmeralda Keta, “Të rinjtë, seks që në klasë të shtatë,” *Gazeta Shqiptare*, 31/05/2010, f.9.

Të shpeshtë janë gazetarët që u drejtohen ekspertëve dhe sidomos psikologëve në temat që kanë të bëjnë me fëmijët, sidomos me adoleshentët dhe me sjelljen e tyre. Për shembull, një prej tyre, i cili fokusohet te adoleshentët dhe pornografia<sup>23</sup> bazohet te mendimet e marra nga dy psikologë të mirënjohur që merren me çështjet e të miturve.

Gjithashtu, një problem që është prekur vazhdimisht në shtyp, në forma të ndryshme, është problemi i fëmijëve të rrugës apo shfrytëzimi i fëmijëve. Edhe gjatë këtij muaji të monitorimit, ky problem është prekur në disa artikuj, duke cituar sidomos organizatat përkatëse dhe ekspertë të ndryshëm në lidhje me këtë plagë në rritje të shoqërisë shqiptare. Një nga këta artikuj thekson mungesën e shifrave të punës së fëmijëve në vend dhe informon për studimet që priten, por ofron dhe shifra të përafërta të prekjes nga ky fenomen nëpër botë: “Aktualisht në botë ka rreth 215 milionë fëmijë që punojnë e nga të cilët 115 milionë janë të përfshirë në punë të rrezikshme për jetën.”<sup>24</sup> Në të njëjtën linjë, një artikull tjetër jep të dhëna më specifike për punën e fëmijëve, në bazë të një studimi:

*“Nga studimi rezulton se fëmijët romë që punojnë i përkasin moshës 3-16 vjeç. Janë evidentuar 415 fëmijë të punësuar. Duke analizuar marrëdhëniet e punës së fëmijëve të evidentuar rezulton se 12% e tyre janë gjetur pa kontrata individuale pune. Pjesa tjetër kanë kontratë dhe punojnë 6 orë në ditë dh eme një kohëzgjatje javore pune 30-36 orë.”*

Gjithashtu, ajo që mund të shtohet në drejtimin e fenomeneve që prekin të miturit është se ka një prirje për të prekur dhe tema të reja, të tilla si teknologjitë e reja, linjat këshillimore për fëmijët, të miturit dhe pornografia, teknologjitë e informacionit, etj. Kështu, njëra nga gazetatat ka dy suplemente brenda muajit për pornografinë dhe fëmijët dhe për nevojën për ndihmë që shprehin fëmijët pranë linjave të posaçme të ngritura për to. Një artikull tjetër flet për problemin e fëmijëve në kopshte që flasin për telenovelat,<sup>25</sup> duke ngritur pikëpyetje për edukimin e mëtejshëm të këtyre fëmijëve. Pra, në përgjithësi mund të thuhet që ekziston një dimension social i pasqyrimin të problemeve të të miturve në gazeta.

Si përfundim, aspekti që mund të thuhet se po përmirësohet në pasqyrimin e të miturve ka të bëjë me prekjen e problemeve të tyre jo më vetëm nga ekspertët apo nga statistikat, por dalngadalë edhe nga ata vetë, duke rritur ndërgjegjësimin me anë të dëshmimeve dhe zërave të vetë fëmijëve. Gjithashtu, prëforcimi i përshkrimeve të problemit duke përdorur opinionet e ekspertëve, raportet zyrtare, statistikat dhe intervista të ndryshme, ka sjellë një përmirësim të trajtimit të fenomeneve për publikun. Megjithatë, mbetet ende shumë punë për të bërë në këtë aspekt, sidomos përsa i përket sistematikës së ndjekjes së fenomeneve dhe shmangjes së notave sentimentaliste që hasen shpesh në këto raste.

### **Suplementi “Gjinnazistët”**

Një praktikë që ka nisur në vitet e fundit ka qenë nisma e “Gazeta Shqiptare,”: botimi i një suplementi të përjavshëm vetëm për gjinnazistët. Gjatë gjithë vitit shkollor, një herë

<sup>23</sup> Esmeralda Keta, “Pornografia për të mitur, një epidemi e rrezikshme,” *Gazeta Shqiptare*, 13/05/2010, f.

<sup>24</sup> “Puna e fëmijëve, nis monitorimi i 8000 familjeve në mbarë vendin,” *Gazeta Shqiptare*, 16/05/2010, f.11.

<sup>25</sup> Ermelinda Hoxhaj, “Fëmijët në kopshte diskutojnë për telenovelat,” *Gazeta Shqiptare*, 04/05/2010, f. 10.



në javë, gazeta përqendrohet vetëm me atë që ndodh nëpër gjimnazet e kryeqytetit, duke krijuar një hapësirë për këtë grupmoshë, e cila rrallë ka mundësinë të shprehet në median e shkruar. Për më tepër, ndryshe nga çdo hapësirë tjetër që u kushtohet të miturve, në këtë supplement gjimnazistët mund të shkruajnë edhe vetë, siç ndodh shpesh, e jo të shprehen vetëm nëpërmjet gazetarëve.

Suplementet përshkruajnë kryesisht problemet e përditshme të gjimnazistëve, duke nisur nga problemet infrastrukturore në shkollë, sfidat me të cilat përballen arsimi e ata vetë, ngjarjet jashtëshkollore, përplasja mes brezave apo marrëdhëniet mësues-nxënës, e deri te mënyra e jetesës së këtij brezi.

Në përgjithësi, përmbajtja e artikujve në këto suplemente është mjaft e larmishme dhe përpiket të japë një pamje sa më të plotë të problematikës së këtij grupi. Për më tepër, suplementet u lënë mundësi dhe vetë gjimnazistëve të shprehen për probleme që i shqetësojnë. Jo rrallë në këto suplemente gjen letra shpjeguese ose mendime të firmosura nga një klasë e tërë. Gjithashtu, informacione për aktivitete jashtëshkollore si faqe interneti të ngritura nga ata vetë, pjesë teatrore të vëna në skenë, konkurse letrare, etj, shkruhen me raste edhe nga vetë gjimnazistët. Pra, kjo hapësirë për gjimnazistët jo vetëm është ekskluzivisht për ta dhe mbi ta, por sjell dhe vetë optikën e tyre për problemet dhe temat e ndryshme që trajtohen.

Ashtu si dhe pjesë të tjera të gazetës, çdo supplement boton dhe një rubrikë të ngjashme me “pyetje e përgjigje,” ku psikologu u përgjigjet pyetjeve të bëra nga gjimnazistët për probleme që i shqetësojnë. Problemet janë nga më të ndryshmet, si grindjet në familje, kontrolli i prindërve, emocionet kur ngrihen në mësim, droga në shkollë, marrëdhëniet mes gjimnazistëve, etj. Kjo rubrikë, përveçse krijon një mundësi shprehjeje për vetë gjimnazistët, përbën dhe një lloj hapësire të sigurtë ku ata mund të marrin informacionin dhe këshillat që kërkojnë.

Në përgjithësi, botimi i suplementit “Gjimnazistët” ka krijuar një praktikë të re dhe një qasje ndryshe nga gazetatat shqiptare drejt grupeve që rrallë e gjejnë veten në gazetë. Duke kombinuar qasjen gazetareske me vetë mendimet dhe zërat e gjimnazistëve, suplementi sjell një pamje më të plotë dhe të larmishme me ato çka përballlet ky grup. Për më tepër, rregullsia në kohë e suplementit e dallon atë nga suplemente të tjera po aq të rëndësishme, por që botohen një ose dy herë dhe harrohen.

### **Pasqyrimi ndryshe**

Përveç monitorimit të gazetave të përditshme, pjesë e këtij projekti ishte dhe realizimi i artikujve dhe reportazheve nga gazetarë të çështjeve sociale në lidhje me aspekte të reja të jetës së fëmijëve apo përpjekje të ndryshme që bëhen për përmirësimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve.

Më konkretisht, reportazhet/kronikat e realizuara përqendroheshin në aspekte të ndryshme të jetës së fëmijëve dhe i paraqisnin shikuesve projekte të ndryshme të kryera për të përmirësuar jetën e fëmijëve në nevojë. Kronikat përfshinin informacion për

projekte të tilla si një shkollë për fëmijët romë dhe egjiptianë që i mbante larg lypjes dhe rrugës, kontrastin mes jetës së lumtur të disa fëmijëve dhe jetës së fëmijëve që detyroheshin të shisnin apo më keq akoma, të kërkonin nëpër plehra, etj. Nuk mungonin dhe kronikat pozitive, si ajo e një shoqate në Tepelenë, e cila prej vitesh trajtonte fëmijët me zhvillim të vecantë, si dhe kronika informative për fëmijët dhe Internetin, marrëdhënia mes tyre, problemet dhe përparësitë, si dhe roli i familjes dhe shoqërisë në këtë aspekt.

Disa nga kronikat sillnin edhe zërat e fëmijëve, një aspekt që nuk haset shpesh në median shqiptare. Megjithatë, konsideratat etike kishin përparësinë, pasi fëmijët që donin të flisnin, por jo të identifikoheshin, u shfaqën me fytyra të fshehura.

Një element thelbësor të projektit, por edhe të monitorimit, përbënin artikujt e shkruar si rezultat i vizitave nëpër projektet e organizatave të ndryshme që punojnë me fëmijët. Kështu, u kryen katër vizita në rrethe dhe një në Tiranë, të cilat kishin për qëllim që gazetarët të informoheshin dhe të informonin dhe publikun për përpjekjet e vazhdueshme të zhvilluara me qëllim që të përmirësohet jeta e fëmijëve dhe që të ndihmohen grupe të caktuara në nevojë.

Si pasojë e këtyre udhëtimeve, gazetarët kishin mbështetjen e OJQ-ve qendrore dhe lokale dhe patën mundësinë të shihnin me sytë e tyre punën që po bëhej. Përvoja e tyre u pasqyrua në artikujt e botuara, gjithsej 30 artikuj, në disa nga gazetatat kryesore.

Më konkretisht, artikujt përqendroheshin në tema dhe këndvështrime të ndryshme, si p.sh. strukturat lokale të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve, problemet e trafikimit të brendshëm, lufta kundër analfabetizimit dhe braktisjes së shkollës, lufta kundër shfrytëzimit të fëmijëve, siguria e fëmijës brenda familjes, etj. Për të shkruar këto artikuj, gazetarët bashkëpunuan ngushtë me përfaqësues të ndryshëm të shoqërisë civile. Për rrjedhim, edhe informacioni i përcjellë ishte më i informuar dhe mundësoi edhe perspektiva apo këndvështrime të reja, në krahasim me pasqyrimin e mëparshëm të bërë thjesht nga kryeqyteti.

## **Përfundimet**

Në përgjithësi, mund të thuhet se problemet e fëmijëve po fillojnë të shfaqen gjithnjë e më shumë në faqet e gazetave shqiptare. Ato zënë një vend gjithnjë e më shumë të konsiderueshëm.

Në krahasim me monitorimet e mëparshme, ku mund të thuhej pa ngurrim se kronika e zezë ishte një magnet për shtypin, situata duket të ketë ndryshuar disi, të paktën për periudhën e monitoruar.

Një tjetër prirje që mund të vihet re në pasqyrimin e të miturve në median shqiptare është ajo i marrjes së tyre nën mbrojtje. Ndërkohë që ka një numër në rritje të artikujve që tregojnë se gazetarët kanë marrë përsipër të ndihmojnë një kauzë apo një rast të veçantë,

në këtë mision është e vështirë të shmangen notat sentimentaliste, duke u prirur të vihen nevojat e fëmijëve para dinjitetit të tyre.

Fatmirësisht, gazetat shqiptare po hapen gjithnjë e më shumë për problemet dhe tematikat e ndryshme që shqetësojnë të miturit. Temat e gazetave nuk kufizohen më vetëm te kronika e zezë, por edhe te shëndeti, arsimi, braktisja, apo problemet psikologjike që shqetësojnë të miturit. Në këto artikuj shpesh ndërthuren këshillat e ekspertëve dhe përvojat e vetë të miturve, duke u përpjekur kështu të përmbushet dhe një rol edukativ dhe informativ për këto probleme.

Mbulimi i fëmijëve dhe problemeve të tyre nuk është më një temë periferike, por po zë gjithnjë e më shumë vend në hapësirat e faqeve sociale në shtypin shqiptar. Megjithatë, pasqyrimi i fëmijëve në media, edhe pse mjaft i përmirësuar, është ende larg të qenit i rregullt, sistematik, i përthelluar, apo tërësisht etik. Përpjekjet për të pasqyruar fëmijët dhe për t'u dhënë atyre një zë të vërtetë dhe vendin që meritojnë duhet të vazhdojnë edhe më tej, në përputhje me vendin që meritojnë dhe me nivelin e profesionalizmit që dëshiron të arrijë media shqiptare.